

VENDIM
Nr. 713, datë 20.11.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 965, DATË 25.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK MINISTRIA E FINANCAVE DHE MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, TË PRONËS ME NR. 37, ME EMËRTIMIN ‘MINISTRIA E MBROJTJES’, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN ‘DËSHMORËT E KOMBIT’, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 965, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në titull dhe në përmbajtje, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku